

## **KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PER STUDIMET E DOKTORATËS**

1. Të jenë pranuar në njërin prej 15 universiteteve më të mira të botës në shkencat shoqërore dhe ekonomike, apo në njërin prej 50 universiteteve më të mira të botës në shkencat natyrore dhe teknike, sipas renditjes së fundit, të përgjithshme dhe/ose asaj specifike sipas fushave, të “Times Higher Education”- Renditja botërore e universiteteve, ose të jenë pranuar në njërin prej universiteteve të mirënjohura ndërkombëtare për studime në albanologji;
2. Të mos marrin shpërblime si financim i plotë apo bursë e plotë për punën kërkimore apo mësimore që bëjnë gjatë këtyre studimeve në universitetin pritës në vlerë më të madhe se ajo e parashikuar për financim nga Fondi i Ekselencës. Studentët doktorantë nuk mbështeten financiarisht nga ky fond për tarifën e studimeve (tuiton fee) por vetëm për shpenzimet e jetesës. Në rastet kur studenti përfiton një financim tjetër nga universiteti pritës apo nga donatorë të tjerë, financimi nga Fondi i Ekselencës do të bëhet për diferencën e vlerës deri në vlerën maksimale të parashikuar nga ky fond;
3. Të pranojnë të punojnë, së paku, 3 (tre) vjet në Shqipëri, pas përfundimit të studimeve të doktoratës.
4. Të jenë shtetas shqiptarë;
5. Të mos jenë, njëkohësisht, përfitues të ndonjë burse tjetër nga shteti shqiptar.

### **DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESË KANDIDATI:**

#### **1. BURSA TË POSAÇME, PËR STUDENTËT, QË NDJEKIN STUDIMET E DOKTORATËS JASHTË VENDIT.**

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MASR [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al));
2. Diplomat e studimeve universitare të ciklit të parë dhe të dytë, së bashku me aneksin e notave;
3. Letër pranimi nga institucioni pritës i arsimit të lartë ku të përcaktohet programi i doktoratës ku kandidati është pranuar, kohëzgjatja zyrtare e studimeve të doktoratës dhe udhëheqësi shkencor;
4. Projekt-ideja e temës së doktoratës, në të cilën të paraqitet qartësisht, objekti kryesor i studimit, metodologjia (në varësi të llojit të disiplinës), literatura kryesore që është përdorur apo që do të përdoret potencialisht.

#### **2. BURSA E POSAÇME PËR STUDENTËT E NDËRMJETËM QË NDJEKIN JASHTË STUDIMET E DOKTORATËS**

1. Formular aplikimi (formati shkarkohet nga website i MASR [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al));
2. Deklaratë nga institucioni i arsimit të lartë për periudhën e qëndrimit dhe frekuentimit të institucionit ku kryhet doktorata nga ana e kandidatit (origjinale);
3. Vërtetim i institucionit pritës mbi ciklet e leksioneve të ndjekura dhe rezultatet e arritura (nëse ka) (origjinale);
4. Artikuj të botuar (nëse ka) (origjinale);
5. Raporti i ndërmjetëm i nënshkruar nga udhëheqësi shkencor, në të cilin të përmbledhet gjithë veprimtaria shkencore e kryer gjatë vitit akademik të mbështetur me bursë dhe parashikimi për vitin pasardhës akademik (origjinale);
6. Vërtetim nga universiteti pritës mbi mbështetjen ose jo financiare nga ana e tij për kandidatin, si dhe masën e financimit (origjinale ose fotokopje e noterizuar);
7. Dokumentacion justifikues financiar të shpenzimeve që mbulojnë vlerën e bursës së akorduar